



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në pajtim me dispozitat e nenit 14, pika 14.1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dispozitat e nenit 11 të Rregullores për dhënien e banesave të komunës në shfrytëzim me qira rasteve me përkujdesje sociale, 01 nr. 360 – 1938, të dt. 28.7.2010, Komisioni për çështje banesore, më 2.2.2012 mori Vendim për shpalljen e

**K O N K U R S I T**

**për**

**dhënien e 4 banesave, në shfrytëzim me qira për raste me përkujdesje sociale.**

Të drejtë aplikimi, sipas dispozitave të nenit 7 të Rregullores, ka aplikuesi, i cili:

- a. është shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. është banor i komunës së Prishtinës, së paku 5 vjet para kohës së aplikimit;
- c. ka të pazgjidhur çështjen e banimit dhe nuk është në gjendje ta zgjidhë vetë këtë çështje;
- d. nuk ka patundshmëri;
- e. është në gjendje të rëndë sociale, është në listën e personave apo familjeve që marrin ndihmë sociale, e dëshmuar kjo përmes vërtetimit të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Prishtinë.

Kriteret për vlerësim të aplikuesve janë të caktuar në nenin 9, pika a - c të Rregullores.

Aplikuesi kërkesës duhet bashkëngjitur këto prova:

- a. certifikatën e shtetësisë;
- b. lejen e njoftimit, me të cilën dëshmohet se është banor i komunës së Prishtinës;
- c. vërtetimin se nuk ka pasuri të paluajtshme, shtëpi apo banesë në pronësi të tij në komunën e Prishtinës;
- d. certifikatën e lindjes për secilin anëtar të familjes;
- e. vërtetimin mbi të ardhurat personale të tij dhe të anëtarëve të familjes.

Dokumentet e kërkuara nuk mund të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj nga dita e lëshimit të tyre.

Formularët për aplikim mund të merren dhe të dorëzohen në ndërtesën e Komunës së Prishtinës, rruga "UÇK", nr. 2, kati përdhes, Qendra për shërbim me qytetar, çdo ditë pune prej orës 8:30 deri në ora 15:00.

Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes në të përditshmet "Zëri" dhe "Koha ditore".

Aplikacionet e dorëzuara pas këtij afati nuk do të merren në shqyrtim.

Për informata shtesë njoftimi mund të bëhet përmes tel. 230 - 900 lok. 1123.